




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opštë, Administrativne Poslove
01 Nr./Br. 413101-17691
Data 20.06.18
Gjakovë - Djakovica - Gjakova

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMIT**

**NË MES**

**KOMUNES SË GJAKOVËS**

**DHE**

**OJQ GEORGE WILLIAMS YOUTH ASSOCIATION IN KOSOVO**

## **Palët në Marrëveshje:**

Komuna e Gjakovës, rr. Nënë Tereza nr. 469, dhe OJQ “George Williams Youth Association in Kosovo”, më pas e quajtur si “GWY” e cila është anëtare në Federaten Evropiane të YMCA njëherit organizata e parë e të rinjëve në botë e themeluar më 1844 në Londër, Angli. OJQ GWY punon përfundimisht fuqizimin e rinisë dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre pa dallim feje, race, orientimi seksual, gjinie apo përkatësie politike, regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike me numër të regjistrimit 5114389-2 dhe adresë: Rruga “Ismail Qemali” pn, Gjakovë me përfaqësuese ligjore **Znj. Dorina Davies**.

## **Neni 1 QËLLIMI I MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT**

Qëllimi i Memorandumit është bashkpunimi rreth implementimit te projektit “*Qendra e edukimit jo-formal për rini*” me lokacion në fshatin Pjetërshan në komunën e Gjakovës. Bashkpunimi në këtë projekt ofron një platformë dhe infrastrukturë fizike me kushte shumë të mira për zhvillim të aktiviteteve përfundimtare përfshirë komunitetet pakicë, personat me aftësi të kufizuara, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet shtetërore.

## **Neni 2 OBLIGIMET E PALËVE**

### **2.1. Obligimet e Komunës së Gjakovës**

2.1. Komuna e Gjakovës merr përsipër këto obligime sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi, si në vijim:

2.1.1. Te ofron asistence teknike rreth investimeve kapitale ne nivel komunal përfshirë projektin: “*Qendra e edukimit jo-formal për Rini*” me lokacion në fshatin Pjetërshan në komunën e Gjakovës, i cili do të realizohet gjatë vitit 2018.

2.1.2. Do te prioritizojoj ndertimin e rruges ne vitin 2019 në fshatin Pjetërshan në komunën e Gjakovës ne menyre qe te rinjet dhe te rejat te cilet do te vijne nga tere Kosova dhe rajoni te kene kushte infrastrukturore te pershtathsme ne te gjitha sezonat.

2.1.3. Komuna e Gjakovës bashkë me OJQ George Williams Youth Association in Kosovo do të përcjellin në vazhdimësi realizimin e Projektit dhe iniciojne projekte te reja ne sektorin e rinise te cilat do te sjellin vemendje rajonale Gjakovës ne partneritet.

### **2.2 Obligimet e OJQ George Williams Youth Association in Kosovo (GWY)**

2.2.1. Të bashkpunoj me komunen rreth projektit

2.2.2 Të ofroj programe lokale dhe ndërkombëtare përfundimtare përfshirë komunitetet, personat me aftësi të kufizuara, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet shtetërore.

**Neni 3**  
**ZBATIMI**

Komuna e Gjakovest në bashkëpunim me GWY e përcjellin zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe udhëzojnë për veprimet që duhet të ndërmerren në implementimin e obligimeve në mbarëvajtjen e puneve, deri në momentin e realizimit të qëllimit te perbashket.

**Neni 4**  
**MUNDËSIA E NDËRPRERJES SE MEMORANDUMIT DHE RRETHANAT E PAPARASHIKUARA**

- 4.1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet më marrëveshje ndërmjet palëve.
- 4.2. Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhive të Fuqisë mbinatyrore – Vis major dhe rrethanave tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me palët tjera relevante për veprimet që duhet të ndërmerren.

**Neni 5**  
**AFATI I REALIZIMIT**

Ky Memorandum i Bashkëpunimit fillon me 19 Qershori 2018 dhe përfundon me 19 Qershori 2022, me mundësi vazhdimi.

**Neni 6**  
**AMANDAMENTIMI**

Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshoj apo plotësohet sipas një Marrëveshje me shkrim midis palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë MB, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në MB në të ardhmen, apo në një amendament të këtij MB-je, të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshje do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

**Neni 7**  
**ZGJIDHJA NË RAST TË MOSMARRËVESHLJEVE**

Palët do të përpilen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Gjakove që ka kompetencë të zgjidh rastet e tillë.

**Neni 8**  
**KOPJET DHE GJUHËT E MEMORANDUMIT**

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

**Neni 9**  
**HYRJA NË FUQI**


Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

**Ardian GJINI,**  
Kryetar i Komunes



**Dorina DAVIES,**  
Drejtoreshë

George Williams Youth Association  
in Kosovo



Nënshkruar në Gjakovë, me datë 20/06/2018